



Republika e Kosovës



Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Njësia e Auditimit të Brendshëm

	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAÇ/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No <u>02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)</u>		
Nr./Br./No <u>7180</u> Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>20</u>		
Data/Datum/Date <u>07.04.26</u>		
RAHOVEC / ORAHOVAÇ		

# RAPORT TREMUJOR I PUNËS

Për periudhën 01.01.2026 - 31.03.2026

07.04.2026

## **Raporti i punës së NJAB-së për periudhën Janar-Mars të vitit 2026**

Në perudhën Janar – Mars, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin vjetor të punës për vitin 2026, i cili plan është i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm dhe Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit të Brendshëm.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për periudhën Janar – Mars të vitit 2025, kemi arritur të kryejm 1 (një) auditim, sipas planit vjetor të punës.

### **Drejtoritë e audituara të Planifikuara dhe të realizuara për periudhën Janar – Mars të vitit 2026**


1. Auditimi i Brendshëm në Zyrën e Prokurimit.

### **Aktivitetet dhe angazhimet e tjera të Njesisë së Auditimit të Brendshëm**

Angazhimet tona kryesisht kanë qenë:

- Vlerësimi i objektivave për auditime, sipas shkallës së rrezikshmërisë, është pregaditur Plani Strategjik i NJAB për vitet 2026 – 2028, dhe Plani Vjetor i Punës së NJAB-së për vitin 2026.
- Është pregaditur raporti i gjashtëmujorit të dytë dhe raporti vjetor i NJAB-së për vitin 2025, i janë dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NjQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2025.
- Gjithashtu NjAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e implementimit të rekomandimeve.

Udhëheqësi i NjAB-së



Ruzhdi Kabashi